



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Bulevardi "Zogu I", Godina 57/2, Nr.18 Tirane

Tel/Fax 04 2226814 ; 2226814

Nr. 368/7 Prot.

Tiranë, më 08.10. 2015

V E N D I M

Nr. 110, datë 08/10/2015

“Mbi përfundimin e procedimit administrativ, filluar mbi bazën e ankesës së *** , me Nr. 368 Prot., datë 14.05.2015”**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neneve 16 e 34 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të dokumentacionit administruar me shkresën nr. 368 datë 14.05.2015,

VËREJ SE:

Në datën 14.05.2015, pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka mbërritur informacioni i përcjellë nga ***** me Nr. 368 Prot., në lidhje me ankesën se pozicioni i punës që ai mban si specialist i emergjencave civile në institucionin e N/Prefektit Tropojë, pa të drejtë është shpallur i lirë nga Departamenti i Administratës Publike, ndërkohë që referuar pikës 2 të aktit të emërimit i dalë në datën 28.02.2014 (në të cilën thuhet se marrëdhënia financiare e nëpunësit ***** fillon më datë 24.02.2014) ai duhej të kishte përfituar nga mundësia që jep neni 67/4, i ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”.

***** parashtron se ka filluar punë pranë institucionit të N/Prefektit të rrethit Tropojë, pranë institucionit të Prefektit të Qarkut Kukës me aktin nr. 41, datë 28.02.2014, në pozicionin e “specialistit të emergjencave civile”, dhe vijon pa ndërprerje ushtrimin e kësaj detyre. Departamenti i Administratës Publike pasi ka shqyrtuar dokumentacionin e punësimit të

këtij nëpunësi, ka arritur në përfundimin se pozicioni i tij i punës duhet të konsiderohet pozicion i lirë dhe me shkresën nr. 3286/12, datë 30.10.2014, është shprehur, për shpalljen e konkurimit për këtë pozicion: *Specialist i Emergjencave Civile pranë N/Prefekturës Tropojë*, për shkak se akti i emërimit ka dalë pas fillimit të efekteve të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” pa respektuar procedurat e rekrutimit.

Nëpunësi ***** duke e konsideruar të padrejtë analizën dhe përfundimin e Departamentit të Administratës Publike, ka kërkuar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, trajtimin e rastit dhe ndërprerjen e konkurimit, duke njohur statusin e nëpunësit civil, të përfutuar në bazë të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”.

Duke analizuar këtë pretendim dhe duke shqyrtuar dokumentacionin e mbledhur në kuadrin e verifikimit të këtij rasti, rezulton se akti i emërimit nr.41, dt. 28.02.2014, nuk është arsyetuar prej organit kompetent, në mënyrë bindëse që të argumentojë nevojën e fillimit të efekteve financiare 4 ditë para daljes së tij (*me fuqi prapavepruese*), ashtu siç kërkohet prej nenit 112, pika 2, të ligjit nr. 8485, datë. 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të RSH”, gjë e cila bën të arrihet në përfundimin se kemi të bëjmë thjesht, me një favor që i është bërë nëpunësit në fjalë, për të përfutuar statusin e nëpunësit civil, në bazë të nenit 67/4 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”.

Nisur nga gjithë sa më sipër, arrihet në përfundimin se fuqia juridike e aktit administrativ nr. 41, datë 28.02.2014, i Prefektit të Qarkut Kukës, ka filluar ditën e daljes së aktit, dhe nuk mund të pranohet se ka fuqi prapavepruese, përderisa nuk gjendet i argumentuar dhe i mbështetur në ligj, prandaj me të drejtë Departamenti i Administratës Publike, nuk e ka marrë në konsideratë dhe e ka shpallur pozicionin të lirë, për tu plotësuar me anë të procedurës së konkurimit (*siç shprehet në shkresën e tij, nr. 3286/12, dt. 30.10.2014*). Në këtë vështrim, duhet thënë që për nëpunësin ***** nuk ka pengesë ligjore të marrë pjesë në këtë konkurrim, njësoj si çdo pretendent tjetër.

Nisur nga gjithë sa më sipër, arrihet në përfundimin se mënyra si është vepruar dhe vlerësimi i situatës dhe akteve nga ana e Departamentit të Administratës Publike, për rastin në fjalë, është i drejtë dhe procesi administrativ i nisur duhet të vazhdojë rregullisht, me kryerjen e procedurës së konkurimit.

Për këto arsye,

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenin 14 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe nenin 34 të Rregullores “Mbi Procedurat

e mbikëqyrjes/inspektimit”, të miratuar me Vendimin nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A :

1. Përfundimin e procedimit administrativ për verifikimin e ankesës së punonjësit *****
2. Të njoftohet për këtë vendim shtetësi ***** dhe Departamenti i Administratës Publike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA